29917

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE
T I R A N E
NR.--23317---AKTI.

VENDIM

PER RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK
I

Ne Tirane (sot), me date 24/ 6/2003, une gjygjtari I Gjykates se shkalles se Pare Tirane Ornela Cojo, mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentacionin e paraqitur nga kerkuesi z. Haxhi Çullhaj , me cilesine e ortakut te vetem dhe administratorit te Shoqerise "FIORI-CULTURA-ÇULLHAJ"SH.P.K., persa I perket regjistrimit te kesaj shoqerije si person juridik prane kesaj Gjykate.

K O N S T A T O V A

Kerkuesi ka paraqitur kerkesen prane kesaj Gjykate per regjistrimin si person juridik te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "FIORI-CULTURA-ÇULLHAJ"SH.P.K., me objekt te veprimtarise se saj:

- -Kultivimin, Mbledhjen, Grumbullimin, Magazinimin , Tregtimin, Esportimin , Importimin e Bimeve dhe shkurreve dekorative, Luleve te ndryshme dekorative. ------Import –Eksport mallrash dhe artikujsh industriale e ushqimore, bime dekorative , lule , pjese kembimi per automjete.
- -Krijimin e nje Auto-Oficine per Riparimin mekanik te automjeteve te tonazheve te ndryshme .
- -Tregtim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industriale, elektro-shtepiake, pjese kembimi per automjete .
- -Tregtim me pakice vajra lubrifikante
- -Transport kombetar dhe Nderkombetar mallrash dhe artikujsh te ndryshem

Ortaku I vetem I Shoqerise eshte z.Haxhi ÇULLHAJ
Kapitali themeltar I Shoqerise eshte 100.000(nje qind mije ) leke .
Selia e shoqerise eshte ne Cerrik, Lagja Nr. 2 .
Administrator eshte z. Haxhi ÇULLHAJ .
Kohezgjatja e Shoqerise eshte mbi 10 vjet.
Kerkesa eshte e drejte dhe ne baze te ligjit duhet pranuar.

PER KETO ARSYE.

Ne baze te ligjit nr.7667 dt. 28.01.1993"Per regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqeria Tregtare" dhe te ligjit 7638 dt. 19.11.1992"Per Shoqerite Tregtare",

V E N D O S A :

-Pranimin e kerkeses.

-Regjistrimin si Person Juridik te Shoqerise "FIORI-CULTURA-ÇULLHAJ "' SH.P.K., me objekt veprimtarie;

- -Kultivimin, Mbledhjen, Grumbullimin, Magazinimin , Tregtimin, Esportimin , Importimin e Bimeve dhe shkurreve dekorative, Luleve te ndryshme dekorative. ------Import –Eksport mallrash dhe artikujsh industriale e ushqimore, bime dekorative , lule , pjese kembimi per automjete.
- -Krijimin e nje Auto-Oficine per Riparimin mekanik te automjeteve te tonazheve te ndryshme .
- -Tregtim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industriale, elektro-shtepiake, pjese kembimi per automjete .
- -Tregtim me pakice vajra lubrifikante
- -Transport kombetar dhe Nderkombetar mallrash dhe artikujsh te ndryshem .

Ortaku I vetem I Shoqerise eshte z.Haxhi Çullhaj .
Kapitali themeltar I Shoqerise eshte 100.000(nje qind mije ) leke .
Selia e shoqerise eshte ne Cerrik, agja Nr. 2 .
Administrator eshte z. Haxhi Çullhaj .
Kohezgjatja e Shoqerise eshte mbi 10 vjet.
Kunder vendimit lejohet akim ne Gjykaten e Shkalles se dyte.

GJYQTAR

23917 Vendim megjithimi

- Emertimi "Flori-Cultura-Gullhaj" Sh.p.k.

- Kapitali 100.000 leke.
- Kohezgjatja mbi 10 vjet
- Me objekt: Kultivimin, mbledhjen, grumbullimin, tregtimin etj.
- Me ortak dhe administrator te vetem Flori Gullhaj
- Me seli Lagje nr 2 Cerrik.

Statuti 6 flete

Akt themelimi 3 flete.

Data e megjithimit 24.06.2003

Data e regjistrimit ~~27~~.06.2003

**AKT THEMELIMI**

**I**

**SHOQERISE TREGTARE "FIORI-CULTURA-ÇULLHAJ " SH.P.K.**

E arritur nga
Haxhi Çullhaj, I biri I Abazit, i datelindjes 28.3.1956, me kombesi shqiptare dhe shtetesi shqiptare, banues ne Cerrik , lagja Nr. 2 , madhor dhe I zote per te kryer veprime juridike i cili me poshte do te quhet **Ortaku I Vetem** I shoqerise , bie dakort te formuloje aktin e themelimit te shoqerise ne perputhje me kerkesat e ligjit 7638 date 19.02.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit nr. 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare", duke vendosur sa me poshte:

**Neni 1**

Te themeloje shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "FIORI-CULTURA-ÇULLHAJ " SH.P.K. e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, dispozitat e kesaj kontrate dhe statutin e shoqerise.
Kjo shoqeri emertohet "FIORI-CULTURA –ÇULLHAJ " SH.P.K.

**Neni 2**

Shoqeria qe themelohet do te kete seline e saj ne Cerrik , ne adresen :Lagja Nr. 2, me te drejte te hapi dege , filiale, zyra , ne te gjithe territorin e vendit dhe jashte saj, duke ushtruar veprimtarine tregtare per nje periudhe kohe mbi 10 vjet.

**Neni 3**

Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise se saj:
-Kultivimin, Mbledhjen, Grumbullimin, Magazinimin , Tregtimin, Esportimin , Importimin e Bimeve dhe shkurreve dekorative, Luleve te ndryshme dekorative. -----
-Import –Eksport mallrash dhe artikujsh industriale e ushqimore, bime dekorative , lule , pjese kembimi per automjete.
-Krijimin e nje Auto-Oficine per Riparimin mekanik te automjeteve te tonazheve te ndryshme .
-Tregtim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industriale, elektro-shtepiake, pjese kembimi per automjete .
-Tregtim me pakice vajra lubrifikante
-Transport kombetar dhe Nderkombetar mallrash dhe artikujsh te ndryshem .

**Neni 4**

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline , objektin e veprimtarise, kohezgjatjen dhe gjithshka tjeter sipas vendimit qe do te marre ortaku I vetem I saj

**Neni 5**

Haxhi Çullhaj

Kapitali themeltar I shoqerise do te jete ne shumen 1.00.000 leke shqiptare dhe kontributi I ortakut te vetem do te jete i ndare ne pjese te barabarta me vlere nominale 1000 leke.

**Neni 6.**

Kapitali I shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit qe do te marre ortaku I vetem. Zmadhimi I kapitalit mund te realizohet si nepermjet kontributeve ne para ashtu edhe nepermjet atyre ne natyre.Zvogelimi I kapitalit do te kryhet jkur kjo gjer motivohet nga humbjet ose kur ortaku I vetem vendos te anulloje pjesen e kapitalit themeltar

**Neni 7**

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashgimie ose brenda familjes ( ndermjet bashkeshorteve, paraardhesve dhe pas ardhesve).
Ortaku I vetem mund ti shese lirisht te treteve teresisht ose pjeserisht kuotat e kapitalit themeltar.

**Neni 8**

Shoqeria do te drejtohet nepermjet vendimeve qe do te marre oprtaku I vetem te cilat do te evidentohen ne nje rregjister. Administrimi I shoqerise do te kryhet nga administratori I saj. Procedura e emerimit, kohezgjatja e mandatit, shkarkimit, kopetencat e administratorit etj. Percaktohen ne satutin e shoqerise.

**Neni 9**

Administratori I pare I shoqerise emerohet z. Haxhi Çullhaj .

**Neni 10**

Shoqeria do ti realizoje transaksionet e saj financiare nepermjet llogarive rrjedhese qe duhet te hape ne bankat shqiptare dhe te huaja. Per kapitalin themeltar te shoqerise eshte hapur libri I llogarive dhe shoqeria ka dhe perdor dokumentacionin financiar ne perputhje me dispozitat ne fuqi per kontabilitetin

**Neni 11**

Shoqeria e fillon veprimtarine e saj tregtare vetem pasi te kete siguruar miratimin e organeve kopetente siç parashikohet ne legjislacionin shqiptar ne fuqi.

**Neni 12**

Kjo kontrate u perpilua me vullnetin e tyre te lire e te plote te Ortakut te Vetem, me kater kopje te njejta, ne gjuhen shqipe, me fuqi te barabarte ligjore, per tu depozituar ne organet gjygjesore e tatimore, si dhe ne dokumentat baze te shoqerise.

**Per shoqerine tregtare "FIORI-CULTURA-ÇULLHAJ ' SH.P.K.**

Haxhi Çullhaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE ELBASAN
Nr. Rep.
1110

# VERTETIM

Vertetoj se sot ne date 17.6.2003, ne zyren time noteriale, para meje noterit Ilda Peza u paraqit personalisht z. Haxhi Cullhaj ,lindur dhe banues ne Cerrik, me datelindje 1956, me detyre administrator I shoqerise tregtare "FIORI CULTURA CULLHAJ , SH.P.K., I njohur prej meje personalisht , madhor dhe I afte per te kryer veprime juridike I cili firmosi para meje me vullnet te lire ne cdo faqe dhe ne fund Aktin e Themelimit te shoqerise tregtare "FIORI CULTURA CULLHAJ " SH.P.K. te hartuar ne daten 17.6.2003.

Noteri
Ilda Peza

# S T A T U T

## I

## SHOQERISE " FIORI-CULTURA-ÇULLHAJ " SH.P.K.

### KREU I.

### KRIJIMI FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI

#### NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "FIORI-CULTURA-ÇULLHAJ " SH.P.K. me seli ne Cerrik , lagjia Nr. 2 ,eshte krijuar sipas kontrates se ciles I bashkengjitet ky statut, me date 17.6.2003(shtatembedhjete qershor ), I hartuar dhe nenshkruar nga Ortaku I Vetem I saj z. Haxhi Çullhaj.

#### NENI 2

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregetare ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, te Ligjit 7638 date 19.11.1999 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit nr. 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare" si dhe ne perputhje me dispozitat e ketij statuti. Shoqeria e fiton personalitetin e saj juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar te Gjykates se rrethit Tirane.

#### NENI 3

Emertimi I shoqerise eshte "FIORI-CULTURA-ÇULLHAJ" SH.P.K.

#### NENI 4

Shoqeria tregtare "FIORI-CULTURA-ÇULLHAJ " SH.P.K. ka per objekt te veprimtarise se saj :

- -Kultivimin, Mbledhjen, Grumbullimin, Magazinimin , Tregtimin, Esportimin , Importimin e Bimeve dhe shkurreve dekorative, Luleve te ndryshme dekorative. ------Import –Eksport mallrash dhe artikujsh industriale e ushqimore, bime dekorative , lule , pjese kembimi per automjete.
- -Krijimin e nje Auto-Oficine per Riparimin mekanik te automjeteve te tonazheve te ndryshme .
- -Tregtim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industriale, elektro-shtepiake, pjese kembimi per automjete .
- -Tregtim me pakice vajra lubrifikante
- -Transport kombetar dhe Nderkombetar mallrash dhe artikujsh te ndryshem .

#### NENI 5

Selia e shoqerise eshte ne adresen lagjia "Nr. 2",Cerrik , Elbasan .
Ajo mund te hape filiale, zyra,dege ne te gjithe qytetin ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi. Shoqeria ka vulen me emrin e saj.

Haxhi Çullhaj

## NENI 6

Kohezgjatja e shoqerise eshte per nje periudhe mbi 10 vjet

## KREU II

## KAPITALI THEMELTAR

## NENI 7

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100.000.( njeqind mije )leke shqiptare.Kapitali themeltar I shoqerise perbehet nga kontributi ne para I ortakut te vetem.
Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar e shlyer krejtesisht e pastaj jane ndare ne kuota me vlere nominale ne shumen 1000 ( nje mije) leke.

## NENI 8

Me vendimin e ortakut te vetem, kapitali I shoqerise mund te zmadhohet nepermjet kontributeve ne para ose ne natyre. Po keshtu mund te zvogelohet kur kjo gje motivohet nga humbjet qe peson shoqeria.

## NENI 9

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashgimie, ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve, ndermjet bashkeshorteve si dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

## NENI 10

Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen te treteve vetem me miratim te ortakut te vetem.Po keshtu shoqeria mund te perfshihet ne sht-blerej aksionesh me shoqeri te tjera duke u kthyer ne filial, shoqeri kontrolluese, ose e kontrolluar nga ndonje shoqeri tjeter.

## NENI 11

Ne cdo rast, transferimi te pjeseve te kapitalit themeltar , duhet te vertetohet me nje akt noterial.

## KREU III.

## MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI, KOPETENCAT DHE KONTROLLI I SHOQERISE

## NENI 12

Te gjitha vendimet e shoqerise merren nga ortaku I vetem duke u bazuar ne dispozitat ligjore te percaktuara ne ligjin "Per shoqerite Tregtare"ne lidhje me marrjen e vendimeve.Ai vendos vete kryesisht per keto çeshtje:

- Miraton planin dhe programin e zhvillimit dhe aktet e pergjithshme te shoqerise

- Merr vendime per ndryshimin e formes, emertimit,selise,kapitalit, veprimtarise se shoqerise, ndryshimi ne zoterimin e kuotave te kapitalit te shoqerise, pranim te ortakeve, pjesmarrjen e shoqerise ne shoqeri te tjetra dhe anasjelltas.
- Miraton raportet financiare dhe bilancin vjetor, vendos per perdorimin e fitimit,organizimin e shoqerise dhe prishjen e saj.
- Emeron dhe shkarkon administratorin, likuidatorin, ekspertet kontabel si dhe drejton veprimtarite e rendesishme te shoqerise.
- Emeron dhe shkarkon drejtuesin teknik te shoqerise.

Marrja e vendimeve realizohet me inisiativen e ortakut te vetem ose me kerkese te administratorit ose ekspertit kontabel, te cilet ne kete rast duhet ti njoftojne ortakut projektin dhe relacionin shpjegues 15 dite perpara takimit.

## NENI 13

Shoqeria administrohet nga nje peson fizik, qe mund te jete vete ortaku I vetem ose nje person tjeter I emeruar ne kate detyure.
Administrator I pare I shoqerise emerohet z. Haxhi Çullhaj .
Administratori ka te gjitha kopetencat per te kryer veprimet e administrimit,ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj, nepermjet kopetencave te precaktuara ne kete statut.
Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te ortakut te vetem.
Kohezgjatja e mandatit te administratorit eshte per 3 (tre) vite financiare rradhazi dhe mund te perseritet.
Mandati perfundon perpara ketij afati kur administratori nuk ploteson kushtet per te kryer kete detyre, jep doreheqjen prej saj, shkarkohet me vendim te ortakut te vetem te shoqerise ose nga nje vendim gjykate.

## NENI 14

Administratori eshte pergjegjes, sipas rastit, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

## NENI 15

Disa nga kopetencat qe I jepen administratorit jane:

- Te siguroje drejtimine mire te veprimtarise tregtare te shoqerise.
- Te administroje pasurite e shoqerise
- Te perfaqsoje shoqerine ne marredhenie me te tretet.
- Te perfaqsoje shoqerine ne marredheniet me organet e institucionet shteterore, para organeve gjygjesore vete ose duke autorizuar persona te tjere kopetente.
- Te kryeje veprime juridike ne emer e per llogari te shoqerise me te tretet si: te lidhe kontrata, te kryeje veprime bankare te ndryshme si celje llogarish, marrje kredie, transferta etj.

## NENI 16

Kontrolli I veprimtarise ekonomiko-financiare te shoqerise realizohetr nga nje ekspert kontabel I pavarur, I cili emrohet dhe shkarkohet me vendimte ortakut te vetem.

Haxhi Çullhaj

## KREU IV

## VITI FINANCIAR DHE LLOGARITE VJETORE.

### NENI 17.

Viti financiar fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor.Perjashtimisht nga kjo viti I pare financiar ka filluar diten e themeilimit te shoqerise si person juridik.

### NENI 18

Llogarite vjetore , inventaret, raportet mbi veprimtarine e viti financiar te hartuara nga administratori dhe ekspert I kontabel I atorizuar, miratohen nga ortaku I vetem brenda nje afati prej 6-muaj nga mbyllja e vitit financiar.

### NENI 19.

Bilanci vjetor I veprimtarise nxirret mbrenda dates 31 mars te vitit pasardhes.

### NENI 20

Fitimet neto te realizuara nga veprimtaria e shoqerise, mbasi te jene zbritur te gjitha shpenzimet e kryera , detyrimet fiskale, rezerva e domosdoshme etj, I shperndahen ortakut ose me vendim te tij mund te perdoren per investime, nxitjen e veprimtarise tregtare, reklame dhe per cdo qellim tjeter te ligjshem dhe qe I sherben shoqerise.

### NENI 21

Shoqeria ka te drejten e perdorimit lirisht te fitimit dhe disponimit te pasurise se saj ne perputhje me qellimin e objekti te veprimtarise qe kryen.

### NENI 22

Detyrimet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise, ajo I mbulon nga fondi rezerve ose nga shuma suplementare.

### NENI 23

Shoqeria gezon te gjitha te drejtat , per mbrojtjen e pasurise se saj, te parashikuara nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

## KREU V.

## PUNESIMI NE SHOQERI

### NENI 24

Marredhenet juridike mes shoqerise dhe personave qe punesohen ne te rregullohen nepermjet kontratave te punes, bazuar ne Kodin e Punes dhe dispozitat e tjera ligjore ne fuqi.

## KREU VI.

## PRISHJA E SHOQERISE LIKUJDIMI

### NENI 25

Shoqeria prishet perpara kohe kur:

- Rezultati ekonomik I aktivitetit te saj per disa vite rradhazi eshte me humbje
- Per shkaqe te parashikuara shprehimisht ne ligj
- Ne cdo rast tjeter me vendim te ortakut te vetem

### NENI 26

Shoqeria mund te shpallet ne likujdim me vendim te ortakut te vetem te saj , ose nepermjet nje vendimi nga gjykata ne baze te ligjit.
Ajo hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e marrjes se vendimit. Per realizimin e ketij procesi ortaku ose gjykata emerojne nje ose me shume likujidatore, te cilet pregatisin dhe paraqesin raportin perbylles te aktivit dhe pasivit te shoqerise dhe bilancin perkates.

## KREU VII.

## KUSHTE TE TJERA

### NENI 27

Te gjitha vendimet e marra nga ortaku I vetem evidentohen ne nje liber te vecante, I cili administrohet ne seline e shoqerise.

### NENI 28.

Per te gjitha mosmarrveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim , organi kopetent per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit ku ka seline shoqeria, referuar ne legjislacionin shqiptar ne fuqi.

**PER SHOQERINE TREGTARE "FIORI-CULTURA-ÇULLHAJ " SH.P.K.**
**ORTAKU I VETEM**
**( Haxhi ÇULLHAJ )**

Haxhi Çullhaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE ELBASAN
Nr. 1110 Rep.

# VERTETIM

Vertetoj se sot ne date 17.6.2003, ne zyren time noteriale, para meje noterit Ilda Peza u paraqit personalisht z. Haxhi Cullhaj ,lindur dhe banues ne Cerrik, me datelindje 1956, me detyre administrator I shoqerise tregtare "FIORI CULTURA CULLHAJ , SH.P.K., I njohur prej meje personalisht , madhor dhe I afte per te kryer veprime juridike I cili firmosi para meje me vullnet te lire ne cdo faqe dhe ne fund Statutin e shoqerise tregtare "FIORI CULTURA CULLHAJ " SH.P.K. te hartuar ne daten 17.6.2003.

Noteri
Ilda Peza

BANKA KOMBETARE TREGTARE

**BANKA KOMBETARE TREGTARE SH.A**
**DEGA ELBASAN**

Elbasan me 17-QERSHOR-2003

# VERTETIM

Vertetojme se **"FIORI CULTURA ÇULLHAJ" SHPK** me perfaqesues **Z.HAXHI ÇULLHAJ** ka bllokuar prane BKT DEGA ELBASAN ne nr. e llogarise 405024812 shumen prej 100.000 LEKE (Njeqindmije leke).
E leshojme kete vertetim per efekt regjistrimi ne gjykate..

**DREJTUESJA E OPERACIONEVE**

**NORETA MAKSUTI**

BANKA KOMBETARE TREGTARE SH.A
DEGA ELBASAN

L « 29 NENTORI », RR « 11 NENTORI » , NR 1 ELBASAN TEL/FAX +3555452073
**( HO )** BULEVARDI « ZHAN D"ARK », Tirana-Albania Tel : +355(0)4250955 Fax :+355(0)4250956
SWIFTCODE :NCBAALTX

23917 2 A Copje 24 06 2003

SHOQERIA "FIORI CULTURA CULLHAJ " SH.P.K.
ELBASAN

**KERKESE PER REGJISTRIM SI PERSON JURIDIK**

**GJYKATES SE RRETHIT**
**TIRANE**

Ne baze te aktit te themelimit date 17.6.2003 (shtatembedhjete qershor ) , te normave te statusit te pranuar dhe te nenshkruar nga ortaku I vetem Haxhi Cullhaj themelues I shoqerise "FIORI CULTURA CULLHAJ " SH.P.K. me seli ne Cerrik , Lagja nr 2 , qe ka per objekt:

- -Kultivimin, Mbledhjen, Grumbullimin, Magazinimin , Tregtimin, Esportimin , Importimin e Bimeve dhe shkurreve dekorative, Luleve , te ndryshme dekorative. ------Import --Eksport mallrash dhe artikujsh industriale e ushqimore, bime dekorative , lule , pjese kembimi per automjete.
- -Krijimin e nje Auto-Oficine per Riparimin mekanik te automjeteve te tonazheve te ndryshme .
- -Tregtim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industriale, elektro-shtepiake, pjese kembimi per automjete .
- -Tregtim me pakice vajra lubrifikante
- -Transport kombetar dhe Nderkombetar mallrash dhe artikujsh te ndryshem .

Shoqeria do te kete kapital themeltar 100.000 leke .
Une administratori Agim Salija kerkoj :
Per ushtrimin e profesionit dhe aktivitetit privat ne baze te nenit 5 te ligjit nr, 7512 date 10.8.1991 "Per sanksionimindhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarive private te pavarura dhe privatizimit" te regjistrohem prane kesaj Gjykate si person juridik.
Perfundimisht I kerkoj Gjykates se rrethit Tirane te pranoje kerkesen time dhe te me regjistroje si person juridik.

**A D M I N I S T R A T O R I**

Haxhi Cullhaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE ELBASAN
Nr 1710 Rep.

V E R T E T I M

Vertetoj se sot ne date 17.6.2003, ne zyren time noteriale, para meje noterit Ilda Peza u paraqit personalisht z. Haxhi Cullhaj ,lindur dhe banues ne Cerrik, me datelindje 1956, me detyre administrator I shoqerise tregtare "FIORI CULTURA CULLHAJ , SH.P.K., I njohur prej meje personalisht , madhor dhe I afte per te kryer veprime juridike I cili firmosi para meje me vullnet te lire Kerkesen e shoqerise tregtare "FIORI CULTURA CULLHAJ " SH.P.K. te hartuar ne daten 17.6.2003.

Noteri
Ilda Peza